



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR.06/2024¹ PËR PROCEDURAT
E KONTROLLIT INSPEKTUES

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.06/2024 për Procedurat e Kontrollit Inspektues, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me Vendim të datës 13.09.2024

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 24 paragrafi 6 të Ligjit Nr.04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.1/17 Janar 2013), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5. i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/18 Nëntor 2022), dhe Neni 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) – NR.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr.21.06.2024),

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) NR.06/2024 PËR PROCEDURAT E KONTROLLIT INSPEKTUES

Neni 1 Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen procedurat, format dhe mënyrat e kontrollit inspektues të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera në pikat kufitare të Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Divizionit përkatës për mbrojtjen e bimëve si dhe të gjithë operatorët profesionalë që merren me:

1.1. të gjitha bimët, produktet bimore dhe objektet tjera që janë të përcaktuara në Shtojcën V, pjesa B të Ligjit nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve që importohen nga shtetet tjera dhe janë subjekt i kontrollit fitosanitar;

1.2. certifikatat fitosanitare që shoqërojnë dërgesat dhe certifikatën e origjinës, si dhe dokumentet plotësuese të dërgesës;

1.3. mjetet e transportit - kamionë, vagonë hekurudhorë, kontejnerë etj.;

1.4. materiale paketuese të përdorura për transportin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera;

1.5. materialet paketuese nga druri- në formë të arkave, kutive, sëndukëve, paletave, baterive për kablo dhe rrotave të përdorur për transportin e të gjitha dërgesave të importuara në Kosovë;

1.6. bimët, produkte bimore dhe objekte të tjera të përcaktuara në Shtojcën III, Pjesa A të Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve;

1.7. Të gjitha bimët, produkte bimore dhe objekte të tjera të përcaktuara në nën paragrafët 1.1, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, duhet të jenë të lira nga dëmtuesit të përcaktuara në Shtojcën I, pjesa A dhe Shtojca II pjesa A dhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën IV të Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:
 - 1.1. Ministria nënkupton Ministrinë përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;
 - 1.2. AUV nënkupton Agjencinë përgjegjëse për ushqim dhe veterinarë;
 - 1.3. Departamenti nënkupton Departamentin përkatës për mbrojtjen e bimëve;
 - 1.4. Inspekcioni nënkupton inspektorët përkatës fitosanitar që merren me kontrollin e bimëve, produktet bimore dhe objektet tjera në pikat hyrëse inspektuese kufitare.

Neni 4 Institucioni përgjegjës për kontrollin fitosanitar të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera

1. Inspektorati fitosanitar kufitar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë është përgjegjës për kontrollin fitosanitar të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera në pikat hyrëse inspektuese kufitare.
2. Inspektorët nga paragrafi 1 i këtij neni kryejnë të gjitha inspektimet dhe i përcaktojnë masat e duhura fitosanitare atëherë kur janë të nevojshme.

Neni 5 Importi

1. Importimi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera, kryhet vetëm përmes pikave hyrëse inspektuese kufitare të aprovuara.
2. Lista e pikave hyrëse inspektuese kufitare të aprovuara duhet të dorëzohet në Sekretariatit e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve (në tekstin e mëtejshëm si IPPC).
3. Pikat hyrëse inspektuese kufitare të aprovuara duhet të përmbushin kushtet minimale për të kryer kontrole të shëndetit bimore në pajtim me Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ.
4. Zhdoganimi për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera që i nënshtrohen kontrollit fitosanitar duhet të bëhet vetëm pas kontrollit fitosanitar.

Neni 6 Inspektimi i Importit

1. Bimët, produktet bimore, dhe objektet tjera të përcaktuara në Shtojcën V B të Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve, i nënshtrohen kontrollit inspektues si:

- 1.1. të dokumenteve të nevojshme ku inspektohen elementet si në vijim:

1.1.1. licenca e regjistrimit të importuesit në regjistrin e mbrojtjes së bimëve;

1.1.2. vlefshmëria dhe përmbajtja e certifikatës fitosanitare përcjellëse ose certifikatës fitosanitare për riekспорт;

1.1.3. Krahasimi i të dhënave të paraqitura në certifikatën fitosanitare ose certifikatën fitosanitare për riekспорт me dokumente të tjera përcjellëse si fatura, certifikata e origjinës etj.

1.2. Identitetit ku inspektohen elementet si ne vijim:

1.2.1. bimët dhe produktet bimore duhet të specifikohen në certifikatën përcjellëse fitosanitare ose certifikatën fitosanitare për riekспорт;

1.2.2. Higjiena dhe temperatura e mjetit të transportit duhet të jenë adekuate për llojin e bimëve apo produkteve bimore që transportohen. Temperatura e mjetit të transport duhet të jetë nga 5 - 15°C, me përjashtim të bimëve dhe produkteve bimore specifike.

1.2.3. materialeve të paketimit të drurit të përdorur për transportin e bimëve dhe produkteve bimore, të cilat duhet të jenë të trajtuara dhe shënjuara në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM) 15;

1.2.4. Materiali paketues nga letra duhet të jetë e re, e pa përdorur me parë dhe e pastër, ndërsa materialet tjera paketues nga plastika, druri duhet të jenë te reje, të pa përdorura apo të pastruara dhe dezinfektuara.

1.2.5. çdo paketë duhet me qenë e etiketuar me etiketë në përputhje me standardet e duhura;

1.2.6. integriteti i dërgesës nuk është ndryshuar.

1.3. Shëndetit të bimëve ku inspektohen elementet si ne vijim:

1.3.1. inspektimi vizual i bimëve dhe produkteve bimore për të siguruar që nuk ka simptoma vizuale të organizmave të dëmshëm, të përcaktuara në Shtojcën I A dhe II A të Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve;

1.3.2. nëse ngarkesa përbëhet nga disa kontingjente, secili kontingjent duhet të inspektohet veç e veç;

1.3.3 Inspektimi vizual i mjetit të transportit dhe materialit të paketimit, për të siguruar se është i lirë nga organizmat e dëmshëm.

1.4. Mostrat për testim laboratorik merren:

1.4.1. kur vërehen simptoma të dyshimta ose inspektori fitosanitar kufitar konsideron probabilitetin e pranisë së organizmave të dëmshëm;

1.4.2. bazuar në standarde të duhura ndërkombëtare dhe udhëzuesit të brendshëm.

1.5. Inspektori fitosanitar, mostra të marra do t'i:

1.5.1.pakatoi, ambalazhojë, bllobojë;

1.5.2. kodojë ku kodi i mostrës përbëhet nga kodi i pikës inspektuese, numrit rendor të mostrës, numri identifikues i inspektorit fitosanitar, numrit të protokollit dhe dy numra të fundit të vitit kalendarik si HE/ 3/000/635/18).

1.6. Pikat kufitare inspektuese janë:

1.6.1. PIK: Dheu i Bardhe –DB;

1.6.2. PIK: Hani Elezit – HE;

1.6.3. PIK: Merdarë – ME;

1.6.4. PIK: Mitrovica - MI;

1.6.5. PIK: Peja – PE;

1.6.6. PIK : Prishtina – PR1, PR2 dhe PR3;

1.6.7. PIK: Prizren -PI;

1.6.8. PIK: Jarinje – J.

1.6.9. PIK: Aeroporti-ANP

1.6.10.PIK: Porti i Durrësit.

2. Nëse janë marrë mostrat për testim laboratorik, ngarkesa do të qëndrojë në pikën kufitare nën mbikëqyrjen e inspektorit fitosanitar kufitar dhe nuk mund të lëshohet para se të pranohen rezultatet e testit nga laboratorit përkatës.

3. Përjashtimisht paragrafit 2 të këtij neni, inspektori fitosanitar kufitar mund të lejojë lëvizjen e ngarkesës deri te vendi i destinimit dhe të lejojë zhdoganimin para se të pranohen rezultatet e testit, nëse përmbushen kërkesat si ne vijim:

3.1. mostra e marrë nuk ka qenë me dyshim se ka organizma të dëmshëm dhe prandaj nuk ka rrezik fitosanitar që do të përhapen organizma të dëmshëm.

4. Kontrolli i shëndetit të bimëve kryhet në pikën hyrëse inspektuese kufitare apo në vend të aprovuar të inspektimit.

Neni 7

Inspektimet në vendin e aprovuar të inspektimit

1. Inspektori fitosanitar kufitar mund të lejojë lëvizjen e ngarkesës nga pika hyrëse inspektuese kufitare deri te vendi i aprovuar i inspektimit për kontroll të shëndetit të bimëve nëse kërkesat e tilla janë përmbushura si:

1.1. vendi i aprovuar nga MBPZHR dhe Dogana e Kosovës.

1.2. vendi i plotëson kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të Shtojcës 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

1.3. vendi është i aprovuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

1.4. inspektori fitosanitar kufitar përcakton se ngarkesa nuk mund t'i përhapë organizma të dëmshëm gjatë lëvizjes së ngarkesës deri te vendi i aprovuar i inspektimit.

2. Inspektori fitosanitar kufitar lëshon Dokumentin për lëvizje të shëndetit të bimëve sipas Shtojcës 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Kërkesat për certifikatës fitosanitare

1. Certifikata fitosanitare duhet të jetë në pajtim me kërkesat si ne vijim :

1.1. të lëshohet në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës ose angleze ose në një gjuhë tjetër në bazë të marrëveshjeve bilaterale të autoriteteve zyrtare përgjegjëse të vendeve përkatëse;

1.2. Certifikata nuk duhet të lëshohet më parë se 14 ditë prej datës kur bimët, produktet bimore ose objektet tjera që mbulohen nga ajo certifikate të kenë lënë shtetin eksportues;

1.3. duhet të përmbajë Deklaratën shtesë nëse kërkohet nga Shtojca IV të Ligji për mbrojtjen e bimëve.

1.4. Të gjitha rubrikat duhet të plotësohen ose kur nuk ka shënim, kolona duhet të bllokohet me qellim të parandalimit të falsifikimit.

1.5. ajo nuk duhet të përmbaj ndryshim si dhe fshirje të paautorizuara.

2. Certifikata fitosanitare përfshin vetëm informata në lidhje me çështjet fitosanitare.

3. Certifikatës fitosanitare për riekспорт duhet t'i bashkëngjitet certifikata fitosanitare e vendit eksportues ose kopja e saj e aprovuar - vulosur dhe nënshkruar.

Neni 9

Kërkesat për paketimin nga materiali drunor, dhe materiale tjera të paketimit karton, plastika, metali që përdorën për transport të dërgesave

1. Materiali paketues nga druri duhet të jetë në pajtim me kërkesat si vijon:

1.1 nuk duhet të përmbajë lëvore me përjashtim të ndonjë cope më të vogël se 3 cm në gjerësi - pavarësisht nga gjatësia ose më të mëdha se 3 cm në gjerësi, me sipërfaqe totale të një cope individuale të lëvres më të vogël se 50 cm katrorë.

1.2. duhet të jetë i trajtuar dhe i vulosur në përputhje me ISPM 15 Shtojca 7 e këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Shenja ISPM 15 përmban:



2.1. Kodin e shtetit - ISO dy shkronja (XX në Shtojcën 7 të këtij Udhëzimi Administrativ . Duhet të ndahet me një vizë ndarëse nga kodi i prodhuesit/ofruesit të trajtimit;

2.2. Kodin e prodhuesit-numrin e përcaktuar unik nga NPPO-ja e vendit ku është prodhuar/tregtuar trajtuar materiali paketues nga druri YYY sipas Shtojcës 7 të këtij Udhëzimi Administrativ ;

2.3. Kodi i trajtimit, shkurtesa IPPC në pajtim me përdorimin e masave të miratuara siç janë HT - trajtimi i nxehtësisë, MB - *fumigim me metil bromid*, DH Ngrohje dielektrike, SF trajtim me sulfuril fluorid, (00 – sipas Shtojcës 7 të këtij Udhëzimi Administrativ. Duhet të paraqitet në një vijë të veçantë nga kodi i shtetit dhe kodi i prodhuesit/trajtimit ose të ndahet me një vizë ndarëse nëse paraqitet në të njëjtën linjë si kodet e tjera.

3. Shenja ISPM 15 duhet të jetë:

3.1 në formën kënddrejtë ose katrore dhe e përfshirë brenda një vije kufitare me një vijë vertikale që ndan simbolin e IPPC nga komponentët e kodit;

3.2. nuk duhet të jetë e shkruar me dorë;

3.3. i lexueshëm - i qartë;

3.4. i përhershëm, i qëndrueshëm dhe i pa-transferueshëm;

3.5. i vendosur në vendin e dukshëm, në të paktën dy anët e kundërta të artikullit që duhet certifikuar;

3.6. duhet shmangur përdorimit të ngjyrës së kuqe dhe portokalli pasi që këto ngjyra përdoren për etiketimin e mallrave të dëmshme.

4. Materiale tjera paketuese të përdorura duhet të jenë të pastërta. Materiali paketues nga kartoni duhet të jetë i ri dhe i pa përdorur më parë.

5. Çdo paketim duhet të ketë pasaportën bimore ose deklaracionin të vendosur nga prodhuesi ose paketuesi i autorizuar, ne të cilën shkruhet me ngjyrë të pashlyeshme të gjitha të dhënat për bimën apo produktin bimor.

Neni 10

Vendimet zyrtare që merren nga inspektori fitosanitar

1. Inspektori fitosanitar në pikën hyrëse inspektuese kufitare merr vendim për :

1.1. Aprovimi i importit

1.2. Refuzimi i importit

1.3. Lejimi i lëvizjes së ngarkesës nga pika hyrëse inspektuese kufitare në pikën e aprovuar të inspektimit nën mbikëqyrje fitosanitare për inspektim të shëndetit të bimëve dhe lëshimin e Dokumentit për lëvizje të shëndetit të bimëve;

1.4. Zbatimi i masave fitosanitare – asgjësimi apo trajtimi i ngarkesës.

2. Aprovimi i importit bëhet vetëm kur ngarkesa që importohet është në pajtim me Ligjin për mbrojtje të bimëve si dhe aktet nënligjore që dalin nga zbatimi i këtij ligji.

3. Refuzimi i importit të ngarkesës në Kosovë bëhet në rastet:

3.1. kur ngarkesa nuk ka certifikatë fitosanitare origjinale ose certifikatë fitosanitare për riekспорт dhe nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në Nenin 6 të këtij Udhëzimi Administrativ;

3.2. nëse dokumentacioni i prezantuar - fatura dhe certifikata e origjinës nuk ka përputhshmëri me certifikatën fitosanitare;

3.3. nëse mjeti transportues i bimëve dhe produkteve bimore nuk siguron higjiene të mjaftueshme, dhe nuk siguron temperaturën optimale për transport, varësisht nga kërkesat e llojit të mallit ose së paku të siguron temperature jo më të vogël se 5C° dhe jo më të madhe se 15C°; përveç produkteve të thata bimore.

3.4. Nëse etiketat nuk i përmbushin të gjitha kërkesat e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, dhe nuk janë vendosur nga prodhuesi ose paketuesi;

3.5. nëse bima, produkti bimor apo objekti tjetër është i infektuar me organizma të dëmshme të përcaktuar nga Shtojca I A dhe Shtojca II A të Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve, nëse është vërtetuar me testim laboratorik.

4. Lëvizja e ngarkesës nga pika hyrëse inspektuese kufitare deri në vendin e aprovuar të inspektimit për kontroll të shëndetit të bimëve bëhet nëse janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 7 të

këtij Udhëzimi administrativ dhe dokumentit për lëvizje të shëndetit të bimëve është lëshuar në pikën hyrëse inspektuese kufitare nga inspektori fitosanitar kufitar.

5. Zbatimi i masave fitosanitare:

5.1. Vetëm në raste kur ngarkesa për arsye të ndryshme nuk mund të kthehet në vendin e origjinës, asgjësimi bëhet me qëllim që të shmangët mundësia e përhapjes së sëmundjeve të bimëve atëherë udhëheqësi i inspektionit kufitar fitosanitar formon komision për shkatërrim të ngarkesës ku për veç inspektorit prezent duhet të jenë edhe zyrtari doganor dhe përfaqësuesi i pronarit të bimëve e produkteve bimore;

5.2. Asgjësimi i produkteve të importit bëhet në pikën hyrëse inspektuese kufitare.

6. Në rast të refuzimit të importit, në certifikate fitosanitare apo dokumentet tjera, duhet të vendoset qartë vula e kuqe trekëndëshe, e cila shënon “certifikatën e anuluar” ose “dokumenti i anuluar” nga inspektori fitosanitar kufitar.

Neni 11 Përjashtimet

1. Nëse nuk ka rrezik të përhapjes së organizmave të dëmshëm në Kosovë, lejohen të futen sasi të vogla të bimëve, produkteve bimore, gjërave ushqimore ose gjërave ushqimore të kafshëve për konsum gjatë transportit pa certifikatë fitosanitare,

2. Për import lejohen sasi të vogla për përdorim personal:

2.1. pemë apo perime të freskëta deri 5 kg;

2.2. drithëra deri 5 kg;

2.3. lule deri 2 buqeta;

2.4. lule të mbjella në vazo deri në 5 copë;

2.5. farë – në paketime deri në 200 gr. në masë – jo më shumë se 500 gr.

3. Përjashtimet lejohen gjatë hyrjes në Kosovë, bimët, produktet bimore dhe objekteve tjera për përdorim eksperimental, për arsye shkencore apo për të punuar në zgjedhjen e varieteteve. Aplikohet tek bimët dhe produktet bimore organizmat e dëmshëm të cilave nuk hyjnë tek kërkesat fitosanitare, sidoqoftë për arsye të importit artikujt e tillë të adaptuar duhet të kenë letër zyrtare për hyrje.

4. Materiali paketues nga druri i liruar nga kërkesat e ISPM-së 15 gjatë transportit:

4.1. materiali paketues nga druri 6 mm ose edhe më i hollë;

4.2. paketimet nga druri siç janë tabelat e bykut të presuar, tabela nga druri i fijejuar ose rimeso e krijuar me përdorimin e ngjitësit, me ngrohje apo presion, ose kombinimi i të gjitha këtyre;

- 4.3. fuqitë e verës dhe pijeve alkoolike të cilat ngrohen gjatë prodhimit;
- 4.4. kutitë e verërave për dhuratë, kutitë e cigareve puro dhe artikuj tjerë nga druri i përpunuar ose i prodhuar në mënyrë që nuk paraqet përbërje të dëmtuesve;
- 4.5. byk sharre, fiqe dhe lesh druri;
- 4.6. komponentët nga druri të bashkangjitura përherë në mjetet e transportit dhe kontejnerët;
- 4.7. ngarkesat me dru si trungje pylli/lëndë druri të cilat mbështeten nga përforcues të ndërtuara nga druri i llojit dhe cilësisë së njëjtë dhe që përmbush kërkesat e njëjta fitosanitare sikurse druri në ngarkesë. Këto aksesore përforcues nga druri mund të konsiderohen si pjesë e ngarkesës dhe nuk konsiderohen si material paketues nga druri.

Neni 12

Njoftimi i refuzimit të dërgesës

1. Inspektorati Fitosanitar, duhet të informoj organizatën për mbrojtje bimore të vendit të origjinës apo dërguesin në vendin e tretë për të gjitha rastet kur bimët, produktet bimore ose objektet tjera që vijnë nga vendi përkatës janë ndaluar për shkak të mos përmbushjes së kërkesave fitosanitare të Republikës së Kosovës për import, duke përfshirë kërkesat për materialin paketues nga druri dhe për arsyet e ndalesës, pa paragjykim për veprimet që mund të ndërmerren lidhur me ngarkesën e ndaluar.
2. Informata nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të jepen sa më shpejtë që është e mundur në mënyrë që organizata përkatëse për mbrojtje bimore, kur është e mundur të studioj rastin hollësisht për të ndërmarrë hapat e nevojshëm të parandalimit të ngjarjeve të njëjta.

Neni 13

Mbledhja e taksave

1. Organet përgjegjëse në Kosovë, duhet të siguroj mbledhjen e taksave fitosanitare për të mbuluar shpenzimet që vijnë nga kontrollet zyrtare, identitetit dhe kontrollet për shëndetin bimor, të cilat kryhen sipas paragrafit 2 të këtij neni.
2. Lartësia e pagesës për kontroll:
 - 2.1. kontroll dokumentacioni;
 - 2.2. kontroll identiteti dhe kontroll fizike;
 - 2.3. mostrim dhe testimi laboratorik;
 - 2.4. aktivitetet administrative që përfshinë fletëngarkesat dhe shpenzimet tjera

Neni 14 Transiti

1. Kontrolli fizik/shikim vizual zbatohen për bimët, produktet bimore ose objektet tjera që kalojnë nga një vende në tjetrën dhe kalojnë transit përmes territorit të Republikës së Kosovës nën procedurat e duhura doganore pa ndonjë ndryshim në statusin dhe pa rrezikun potencial të përhapjes së organizmave të dëmshëm.

2. Ngarkesat në transit mund të kalojnë nëpër Republikën e Kosovës, duke qëndruar të mbyllura dhe të bllobuara, atëherë kontrolli fitosanitare për ato zbatohet vetëm kontrolli i dokumentacionit. Inspektori në pikën hyrëse inspektuese kufitare duhet të inspektojë ngarkesat në tranzit me procedurë të shkurtuar, duke inspektuar dokumentacionin përcjellës, dhe mjetin transportues që të sigurohet se bimët dhe produktet bimore që kalojnë nëpër territorin e Kosovës janë bimë të pajisura me certifikatë fitosanitare dhe se mjeti transportues është i mbyllur për të mos lejuar shpërndarjen e sëmundjeve bimore.

3. Transiti i mallrave inspektohet duke:

3.1. Kontrolluar dokumentacionin përcjellës, certifikata fitosanitare ose fitosanitare për re-export, duke vulosur me vulën katrore e cila përmban numrin e protokollit dhe shenjën për lejim transit të mallit;

3.2. inspektohet mjeti transportues dhe ambalazhi të i cili nuk lejohet që mjeti transportues të rrjedhë, të jetë i hapur, dhe të ketë mundësi shpërndarje te sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve gjatë transportit deri në pikën tjetër kufitare;

3.3 duke bërë pagesën për transit të përcaktuara sipas rregullores ne fuqi per caktimin e lartësisë se pagesës se shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Neni 15

1. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ janë:

1.1. Shtojca 1. Kushtet minimale për të kryer kontrolle të shëndetit bimor në Kosovë;

Shtojca 2. Dokumenti për qarkullimin e bimëve të shëndetshme;

1.2. Shtojca 3. Kërkesa për analiza laboratorike;

1.3. Shtojca 4 Formulari L-02 për kontrollin;

1.4. Shtojca 5 Forma e procesverbalit,

1.5. Shtojca 6 mbi pagesat.

1.6. Shtojca 7. Lista kontrolluese per kontroll te importit.

Neni 16
Të hyrat

Te gjitha te hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ derdhen ne Buxhetin e Republikës së Kosovës

Neni 17
Shfuqizimi

Me hyrjen ne fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) NR. 13/2014 për Procedurat e Kontrollit Inspektues, të datës 22.05.2014.

Neni 18
Moszbatimi

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-082 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.24/24 Gusht 2022)

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit ne Gazetën Zyrtare te Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Faton Peci

11 / 11 / 2024

SHTOJCA 1

Kushtet minimale për të kryer kontrole të shëndetit bimor në Kosovë

1. Inspektori Fitosanitar Kufitar në pikën inspektuese, duhet të ketë:

- 1.1. autoritet për të kryer detyrat e tij/saj,
- 1.2. njohuri në identifikimin e organizmave të dëmshëm, apo të ketë mundësin e asaj ekspertize - njohurie të varant,
- 1.3. Fakultetin e Bujqësisë, drejtimi i mbrojtjen e bimëve dhe drejtimet tjera përkatëse,
- 1.4. njohuri në pajisjet dhe mjetet testuese, inspektuese dhe administrative,
- 1.5. qasje në lokacionet e deponimit dhe karantinës së ngarkesave dhe kur është e nevojshme, për shkatërrimin ose ndonjë trajtim tjetër i përshtatshëm, të tërë apo të një pjese të ngarkesës së ndaluar,
- 1.6. në dispozicion
 - 1.6.1. udhëzuesit nacional të shkruar të azhurnuar, duke u bazuar në legjislacionin vendor,
 - 1.6.2. komplet udhëzuesit të azhurnuar të Kosovës për ekspertët dhe për inspektorët vendor,
 - 1.6.3. legjislacionin e azhurnuar të Kosovës për shëndetin bimor,
 - 1.6.4. listën e azhurnuar e cila përmban adresat dhe numrat e telefonit të laboratorëve të specializuara të cilat janë aprovuar zyrtarisht për të kryer teste për përcaktimin e prezencës së organizmave të dëmshëm apo për identifikimin e organizmave të dëmshëm,
 - 1.6.5. Procedura e përshtatshme duhet të aplikohet me qëllim që të sigurohet integriteti dhe siguria e mostrës -mostrave kur zhvendosen për në laborator dhe gjatë proceseve testuese, informacion i azhurnuar për ngarkesat e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera që vijnë nga vendet e treta të cilat kanë kaluar nëpër:
 - 1.6.5.1. ndalesa zyrtare
 - 1.6.5.2. ekzaminimet zyrtare në laboratorë të specializuara së bashku me rezultatet e tyre,
 - 1.6.5.3. të adaptoj programin e krijuar të kontroleve të shëndetit bimor sa më shpejtë që është e mundur në atë mënyrë që të përmbush nevojat aktuale, në fushën e rreziqeve të reja të shëndetit bimor apo ndonjë ndryshimi në sasinë/volumin e bimëve, produkteve bimore ose objekteve tjera të paraqitura në pikat inspektuese të referuara në Artikullin I.

2. Mjetet dhe pajisjet si përcaktohen në paragrafin 1 të kësaj Shtojce, duhet të kenë së paku:

- 2.1. në lidhje me pajisjet administrative,
- 2.2. sistem të shpejtë komunikimi,
- 2.3. autoritetin e Inspektori Fitosanitar,
- 2.4. laboratorët e specializuara duke u referuar në paragrafin 1 të kësaj shtojce,
- 2.5. autoritetet doganore,
- 2.6. komisioni,
- 2.7. shtetet tjera anëtare,
- 2.8. sistem të duplikimit të dokumenteve;

3. Në lidhje me pajisjet inspektuese:

- 3.1. Stereomikroskopi;
- 3.2. Lupa zmadhuese elektrike,
- 3.3. Skalpere,
- 3.4. Letër filtuese,

- 3.5. Musheme,
- 3.6. Pajisje për mostrim,
- 3.7. Zona të përshtatshme për inspektim, siç nevojitet,
- 3.8. ndriqim të mjaftueshëm.
- 3.9. tabela inspektuese.

4. Mjetet e përshtatshme për:

- 4.1. kontrole vizuale,
- 4.2. dezinfektim të lokaleve dhe pajisjeve të përdorura për kontrole të shëndetit të bimëve,
- 4.3. përgatitje të mostrave për testime të mundshme të mëtutjeshme në laborator të specializuar;

5. Në lidhje me pajisjet për marrjen e mostrave në ngarkesa:

- 5.1. materialin e duhur për identifikim dhe paketim individual të çdo mostre,
- 5.2. materialin adekuat paketues për dërgimin e mostrave në laboratorë të specializuara,
- 5.3. vula zyrtare,
- 5.4. ndreqim adekuat.

1. Dokumenti për qarkullimin e bimëve të shëndetshme siç i referohet nenit xx të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) nr. 13/2014 për procedurat e inspektimit në pikat e kontrollit kufitar	2. DOKUMENTI PËR QARKULLIMIN E SHËNDETSHËM TE BIMËVE Nr. KS/...
<p>3. Identifikimi i dërgesës ⁽¹⁾- Kjo dërgesë përmban :</p> <p>Bima, produkti bimor apo objekti tjetër (TARIC kodi): </p> <p>Numri i referencës siç kërkohet në dokumentacionin fitosanitar: </p> <p>Vendi i lëshimit: </p> <p>Data e lëshimit: </p> <p>Shenjat dalluese, numrat, numri i pakove, sasia (pesha/njësit): </p> <p>Numri i referencës së dokumentacionit doganor të kërkuar: </p>	
<p>4. Numri zyrtar i regjistrimit të importuesit: </p> <p>Unë, importuesi i nënshkruar, nëpërmjet kësaj kërkesë kërkoj nga organi përgjegjës zyrtar të kryej kontrollet zyrtare dhe kontrollet e shëndetit të bimës, produkteve bimor te përmendura më lart apo objektet tjera në vendin e lejuar të inspektimit të radhitur më poshtë dhe Unë do t'i respektojë rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga organi përgjegjës zyrtar.</p> <p>Data, emri dhe nënshkrimi i importuesit: </p>	

5.1. <u>Pika e hyrjes:</u>	5.2. Firmosja e dytë nga organi zyrtar i pikës së hyrjes (data, emri, vula e shërbimit dhe nënshkrimi):	
6. Vendi i lejuar i inspektimit		
Dërgesa nuk mund të hjeket në vendet përveç ato të radhitura me sipër, përveç nëse kjo aprovohet zyrtarisht.		
7. Kontroll i dokumenteve <input type="checkbox"/>	8. Kontroll i identitetit <input type="checkbox"/>	9. Kontrolli i shëndetit të bimëve <input type="checkbox"/>
Vendi/ data:	Vendi/ data:.....	Vendi / datë:
Emri:	Emri:	Emri:
Vulë e shërbimit /nënshkrimi:	Vula e shërbimit/nënshkrimi:	Vula e shërbimit/nënshkrimi:

10. Vendimi:

Lëshimi

Vendi/ data:

.....
.....

Emri:

.....
.....

Vula e shërbimit/nënshkrimi:

Tregoni Pasaportën Bimore të EC - së (rendor apo javor apo e radhës) numri nëse është i nevojshëm:

Masa zyrtare

Refuzimi i hyrjes

Shkatërrimin

Qarkullimi jashtë Komunitetit

Periudha karantinë

Heqja e produkteve të infektuara/jo të shëndetshme

Trajtim i duhur

Vërejtje:

.....
.....
.....
.....

(1) Plotësoni në kuti apo referojuni informacioneve të certifikatës Fitosanitare e cila duhet t'i bashkëngjitet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja -
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

**AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË/
 AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO/
 FOOD AND VETERINARY AGENCY**


Data e Marrjes së Mostrave	Adresa e Inspektorit	Telefoni Inspektorit	Qëllimi Analizës	Kodi Insp.	Pika Kufitare

Emri i Institucionit	
Departamenti	
Kërkuesi i analizave	AGJENCIONI USHQIMIT DHE VETERINES I KOSOVES- AUV-
Shifra e Mostrës	
Lloji i mostrës	
Numri serik i fletëpagesës	

KËRKESE PËR KRYERJEN E ANALIZAVE LABORATORIKE

- 1.
- 2.

 Inspektori fitosanitar kufitar



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja -
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

**AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË/
 AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO/
 FOOD AND VETERINARY AGENCY**

Vendi i kontrollimit _____ Nr. i leje.imp. _____ Nr. protokolit _____
 Plsce if inspection _____ Imp. permi _____ Prot nr. _____
 Mesto kontrole _____ Br. uvoz. doz. _____ Br. Protokola _____

VEQORITË E DERGUESES/ PARTICULARS OF CONSIGNMENT/ OPIS

POSILJKE

Importuesi/ Importer/ Uvoznik	Eksportuesi/ Exporter/ Izvoznik		
Mjeti i transportit Means of conveyance Transportna sredstva	Nr. certo. fitos. Phyτος. certif. No. Fitos. Uve. Br.	Certif. e orgj. Certif.. of origin Uveren o porekl	Fletpercjellsja Bill of lading Tovarni list

Nr. Nr. No.	Lloji i mallit / produktit Type of goods./ product. Vrsta robe/proizvoda	Kodi Code Kod	Bruto sasia kg/1 Gross qty kg/1 Bruto količina kg/1	Nr i paketimit No of packages Br. paketa	origjina origin poreklo

Emir i aplikantit _____ data _____ Nr ID _____

Nëshkrimi _____

VENDIMET MBI DËRGESËN E MALLIT/ DECISION ON CONSIGNMENT / REŠENJA O POSIKĆI ROBE

1.Dërgesa në kontroll është shpallur e lire prej organizmave karantinë, dëmtuesit dhe insektet karantine

Consignment on inspection in found to be free from quarantine organisms, injurious diseases and pests

Kontrolisana posiljka je rezultirna slobodna od karantinski organism

2.Dërgesa në kontroll i plotëson kushtet e paraqitura me ligj për ushqim

3.Kërkohet testi laboratorik/ laboratory test required/ zahteva se laboratorska
kontrola

Nr. i procesvrbalit për mostrim

Vendimi/ Decision/ Rešenje

Vula

Peçat

Stamp _____

Ins. Fitosanitar/ phytosanitar inspe/Fitos. Inspektor



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMinistarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja -
MMinistry of Agriculture, Forestry and Rural Development

**AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË/
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO/
FOOD AND VETERINARY AGENCY**

PROCESVERBAL-ZAPISNIK

Për marrjen e mostrave në PIK kufitare - Za uzimanje uzoraka na granicnom prelazu

Data e marrjes së mostrës- Datum uzimanja uzoraka _____ 20 _____

TË PRANISHËM - PRISUTNI

1. _____ Profesionit - Zanimanje _____ Nr.Br.ID _____

2. _____ Profesionit - Zanimanje _____ Nr.Br.ID _____

Emërtimi i mostrës - Naziv uzoraka	
Shifra mostrës - Kod uzorka	
Qëllimi i marrjes së mostrës - Svrha uzimanja uzoraka M.B. F.K. M.R. Yndyra bimore	
Koha e marrjes së mostrës-Vreme uzimanje uzoraka:	
Mënyra e ruajtjes - Način čuvanja:	
I debllobuara me Nr- Debllobirani sa Br	Billombuarë - Blombiran
Nr. qesësë së mostrës - Br kese uzoraka	
Pala dëshiron superanalizë - Stranka zeli super analizu PO _____ DA	
JO _____ NE	
Nr. i protokollit në protokoll inspektimit	
Nr. i portokollit në protokoll analizave	
A informove inspsionin e brendshëm PO _____ DA JO _____ NE	

Vërejtje-Opomena

Nënshkrimi i Palës - Potpis Stranke

Inspektori i Kufirit AUV-it



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMinistarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja -
MMinistry of Agriculture, Forestry and Rural Development

**AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË/
 AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO/
 FOOD AND VETERINARY AGENCY**

I. Lartësia e pagesës për kontrollin fitosanitar në Pikat e kalimit kufitare

1.Lloji i produkteve që importohen në Kosovë edhe lartësia e pagesës në €

Farërat	
Fara për mbjellje, ushqim, ushqimi i kafshëve dhe/ose fara për përpunim industrial (p.sh fara e drithërave, farat bishtajore, etj). Duke përfshirë kokrrën e drithërave ose Produkteve të tyre. Ngarkesat deri në 1.0 ton	€ 30
Ngarkesat mbi 1 ton	€ 2/t
Fara e perimeve	
Nga 0.5 kg deri 5.0 kg	€ 20
Nga 5.0 kg deri 50 kg	€ 25
Nga 50 kg deri 500 kg	€ 35
Mbi 500 kg për çdo 100 kg	€ 5/kg
Frutat	
Frutat e freskëta te citruce (limoni, portokalli, mandarina dhe llojet tjera të pemëve Molla, Dardha, Kajsia, Pjeshka, Qershi etj. Thelboret arra, lajthia etj. Ngarkesat deri në 1.0 ton	€ 30 t
Ngarkesat mbi 1 ton	€ 2/t

Perimet	
Perimet e freskëta ose të ngrira (speci, spinaqi, domatet, lakra, trangulli, karota, shalqiri, kungulli, patate etj. Ngarkesat deri 1.0 ton	€ 30
Ngarkesat mbi 1 ton	€ 2/t
Perimet e bluara (p.sh. biber, mëlmesa e ndryshme)	€ 30
Ngarkesat deri në 1.0 ton	€ 2/t
Kafe, Kakao (produktet e tyre)	€ 40
Ngarkesat mbi 1 ton	€ 4/t
Kërpudhat dhe zhardhokët	
Kërpudhat dhe zhardhokët, të freskëta ose të ngrira, dhe të përgatitura ose të konservuara në uthull ose acid acetik. Ngarkesa deri 1 ton	€ 30
Ngarkesa mbi 1 ton	€ 2/t
Frutat e thata	
Ngarkesa deri ne 1.0 ton	€ 30
Ngarkesa mbi 1 ton	€ 2/t
Pure të pemëve	€ 30
Peme të shtrydhura ose bluara Ngarkesa mbi 1 ton	€ 2/t
Fidanët	
Fidanët e pemëve Ngarkesat deri 100 copë	€ 30
Ngarkesat mbi 100 copë	€ 0,02/copë
Mbishartesat	25/001
Nënshartesat	25 / 001
Fidanët	
Fidanët e perimeve Ngarkesat deri 100 copë	€ 30
Ngarkesat mbi 100 copë	€ 1/ në çdo 100 copë shitesë
Fidanët e dredhëzave, boronicave, mjedrave, manaferrave, aroniave etj.	
Ngarkesat deri 100 copë	€ 30
Ngarkesat mbi 100 copë	€ 0.002/copë
Fidanët e duhanit	
Ngarkesa deri 100 copë	€ 30
Ngarkesa mbi 100 copë	€ 0.01 për copë
Bimët Dekorative	
Ngarkesat deri në 100 copë	€ 40
Bimët dekorative (lulet e prera, drunjtë e këshëndellave etj.) deri në 70 cm	€ 0.01/copë

Bimët në vazo	
Ngarkesat deri në 100 copë	€ 40
Bimët në vazo deri në 70 cm	€ 0.02/ copë
Bimët në vazo mbi 70 cm	€ 0.04/ copë
Fidanet e lulev pa vazo	
Ngarkesat deri në 100 copë	€ 30
Ngarkesat mbi 70 copë	€ 0.002/cop
Druri	
Drurët me lëvore	€ 2/m ³
Drurët pa lëvore	€ 2/m ³
Lëvoret e ndara	€ 1/m ³
Paletat nga drunjtë, paletat kuti materialet drusore për paketim etj.	€ 20/1-50 copa
Dru zjarri, byk sharre etj.	€ 1,5/m ³
Produktet me origjinë bimore, të pa përpunuara ose i janë nënshtruar përgatitjeve të thjeshta dhe / ose ekstraktim mekanik sikurse :	
a) Mielli dhe prodhimet e Miellit	
Ngarkesat deri 1 ton	€ 30
Ngarkesat mbi 1 ton	€ 2/t
b) Lëngjet e frutave dhe perimeve	
<u>Ngarkesat deri 1 ton</u>	<u>€ 30</u>
<u>Ngarkesat mbi 1 ton</u>	<u>€2 /t</u>
<i>Fidanet e bimëve pyjore si: pisha, bredha.....</i>	
<u>Ngarkesat deri 100 copë</u>	<u>€ 30</u>
<u>Ngarkesat mbi 100 copë</u>	<u>€0.002</u>

Shtojca 7

Lista kontrolluese për kontroll të importit

ALB

Pika inspektuese kufitare.....

Nr. i protokolit

Komente / shënime

Neni 5.
Pika
1.1.

I. Kontroll i dokumenteve**Vendi i kontrollit - Pika hyrese inspektuese kufitare**

Neni 5.1.1.1.	1. Licenca e regjistrimit në regjistrin e LMB - në rast të "Jo" ju lutem sqaroni	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	2. Certifikata fitosanitare (CF) nëse kërkohet nga Ligji i mbrojtjes së bimëve:			
	2.1. CF është e bashkangjitur ose	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	CF e RE është e bashkangjitur	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	2.2. CF është origjinale	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	2.3. CF është e vlefshme	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	2.4. CF është në pajtim me dokumente të tjera (fatura, certifikata e origjinës) - në rast të "jo" ju lutemi specifikoni	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6 1.1.	2.5. CF është në shqip, sërbiisht ose anglisht	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6 1.1.	2.5 në një gjuhë tjetër - në rast të "Po" ju lutem sqaroni	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6 1.2.	2.6. CF i adresohet Kosovës	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6	2.7. CF është lëshuar jo më heret se 14 ditë para se të largohet ngarkesa nga vendi eksportues	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6 1.4.	2.8. përmban Deklaratë shtesë nëse kërkohet	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	

Neni 6 1.5.	2.9. të gjitha hapësira të plotësuara ose bllokuara	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6 1.6.	2.10. CF nuk përmban ndryshime të paautorizuara	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 6 3.	2.5. në rast të CF për riekспорт, ju lutem specifikoni se cili dokument është i bashkangjitur:			
	- CF origjinale	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	- kopje e vërtetuar	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	3. Certifikata e origjines (ne rast te importit, jo riekспортit)	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Rezultatet e kontrollit të dokumentacionit (nëse një nga përgjigjet e lartëpërmendura është "jo", atëherë rezultati i përgjithshëm është "jo")	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	

1.2	II. Kontroll i identitetit			
	Vendi I kontrollit - Pika hyrese kufitare			
1.2.1.	1. Bimët/produktet bimore përputhen me CF ose CF për RE	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
1.2.2.	Higjiena përkatësisht temperatura është e duhur (5 - 15C°) - në rast të "Jo" ju lutem sqaroni	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
1.2.2	mjeti transportues për transport të bimëve dhe produkteve bimore është i pastër	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	

	- materiali paketues nga druri (MPD)	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	- karton	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	- plastik	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	

	- metal	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	- tjetër	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 7	MPD:			
Neni 7 1.1.	Nuk përmban lëvore (më shumë se lejohet)	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
Neni 7 1.2.	Është i trajtuar dhe shënjuar	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Përmbushja e kërkesave për materialin paketues			
	Paketimi nga kartoni është i ri dhe nuk është përdorë më heret	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Materiali tjetër i përdorur është i pastër	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
1.2.4.	Materiali paketues përputhet me kërkesat	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
1.2.5.	Etiketimi është i duhur	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
1.2.6.	Integriteti nuk u ndryshua	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Rezultatet e kontrollit të identitetit (ngarkesa i përmbush kërkesat)	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Kontrolli i shëndetit të bimëve do të kryhet në (ju lutem specifikoni vetëm një):			
	- Pikë hyrëse kufitare	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	- Vend të aprovuar të inspektimit	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Lejohet lëvizja deri te vendi i aprovuar i inspektimit për inspektim fizik	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	Emri i vendit të aprovuar për inspektim

Neni 5 III. Kontrolli i shëndetit të bimëve

Pika			
1.3.	Vendi i kontrollit të shëndetit të bimëve:		
	- pika hyrëse kufitare	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	- vend i aprovuar i inspektimit (kontroll i dokumenteve dhe identitetit është bërë në Nr i dokumentit për lëvizje të shëndetit të bimëve)	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
1.3.1.	Inspektim vizual:		
1.3.2.	çdo kontigjent është i inspektuar veçmas	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	simptoma të dukshme të organizmave të dëmshëm	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
1.3.3.	inspektim vizual i materialit paketues për identifikimin e pranisë së organizmave të dëmshme	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	prania e organizmave të dëmshme në materialin paketues	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	Inspektimi vizual i veturës	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	prania e organizmave të dëmshëm në materialin paketues në veturë	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
1.4.1.	Mostra është marrë:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	Sasia e mostrave të marra		
	Rezultatet e kontrollit të shëndetit të bimëve (ngarkesa i përmbush kërkesat)	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>

Neni 8	Vendim i marrë:		
	Import i lejuar	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	Import i refuzuar	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	Zbatimi i masave fitosanitare, ju lutem specifikoni:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	Trajtimi	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
	Shkatërrimi	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
			Vendi i shkatërrimit

Data e inspektimit

Vula

Emri dhe nënshkrimi i Inspektorit
